



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 344/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65652-07-15-2020, me objekt: “Përmirësim furnizimi me ujë në zonën e Kasharit”, me fond limit 13.830.660 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues: “Leon Konstruksion” shpk.
Adresa: Rruga “Tish Daia”, Kompleksi Kika, Pallati 9, Kati 8, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.
Adresa: Rruga e Kavajës, Nr.133, Nësia administrative nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-65652-07-15-2020, me objekt: “*Përmirësim furnizimi me ujë në zonën e Kasharit*”, me fond limit 13.830.660 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a..

II.2. Në datën 21.07.2020, operatori ekonomik ankimues “*Leon Konstruksion*” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kërkesat për kualifikim e konkretisht:

[...]

Shoqëria e ndërtimit “Leon Konstruksion” shpk është njohur me njoftimin e publikimit në portalin e Agjencisë së Prokurimit Publik ëëë.app.gov.al për objektin: “Përmirësim furnizimi me ujë në zonën e Kasharit”, me fond 13.830.660 (Trembëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh, zhvilluar nga autoriteti SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, i cili do të mbahet në datën 17.08.2020.

Kjo procedurë prokurimi është publikuar më datë 16.07.2020 së bashku me të gjithë dokumentat teknik e ligjore të nevojshëm.

Shoqëria jonë pasi ka shqyrtuar në tërësi dokumentat standarte të tenderit hartuar nga Njësia e Prokurimit e SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë, konstaton se kriteret e vendosura janë të ekzagjeruara, jashtë natyrës së objektit të prokurimit, duke cenuar Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Bazuar në pikën 1.1 të nenit 63 “Të drejtat e personit të interesuar” në Kreun VII Procedurat e Rishikimit Administrativ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar i cili thotë: “1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni “, po ju paraqesim për shqyrtim formularin standart të ankimit në lidhje me kriteret e kualifikimit.

Në pikën 12 ju kërkoni: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Çfarë nënkupton autoriteti kontraktor me këtë kapacitet, duke qënë se bazuar në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, kryesisht Neni 47, pika 2/c, të ligjit Klasifikimi i mjeteve rrugore,mjaft qartë jepet përcaktimi i “kamioncinave”, sipas të cilit:

c) - kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;

- kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;

- kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 ton;

Vendosja e këtij kriteri është shumë absurd dhe në kundërshtim me Kodin Rrugor dhe disa nene të ligjit të prokurimit publik.

Neni 1/c e Ligjit Nr. 9643, dt.20.11.2006 (i ndryshuar), kryesisht atë të vet qëllimit që LPP ka:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

Parimet e përzgjedhjes

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;*
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.*

Autoriteti kontraktor duhet të bazohet në parashikimet ligjore, kur kërkon kategorizimin e mjeteve sipas ngarkesave të caktuara, pasi duke mos qënë në përputhje me parashikimet ligjore, kryesisht të ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, con në kufizimin e pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në këto procedura dhe në konkurrencë jo të drejtë.

Pra me fjalë të thjeshta një kamioncinë ka masë maksimale jo më të madhe se 3.5 ton dhe kuptohet shumë thjeshtë që aftësia mbajtëse e tij është më e vogël se kjo masë.

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë arsye ligjore në vendosjen e këtij rregulli si psh: terrene të këqija apo dhe të vështira të cilat nuk lejojnë kamiona mbi këtë peshë pasi vetë autoriteti kërkon kamiona etj.

Gjithashtu e vetmja arsye e vendosjes së këtij kriteri kufizues është uljen e konkurrencës së lirë, mospjesëmarrje të drejtë dhe të lirë të operatorëve ekonomikë.

Nga sa më sipër kërkojmë :

Modifikimin e këtij kriteri ku të kërkojen vetëm

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamionçine</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

SI PËRFUNDIM,

Për sa më sipër kërkojmë nga ana e Autoritetit Kontraktor SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë:

- 1. Pranimi e ankese sonë*
- 2. Shqyrtimin e saj dhe modifikimin e këtij kriter.*

II.3. Në datën 22.07.2020, nëpërmjet shkresës nr.11932/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Leon Konstruksion” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij me pretendimet si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, KSHA konstatoi se ky i fundit ka interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikeën 1, të nenit 63 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar).

Operatori ekonomik “Leon Konstruktion” shpk, nëpërmjet kësaj ankese konteston kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit, përkatësisht kapaciteti teknik pika 12 e DST në të cilën është kërkuar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera

Ne ankesën e paraqitur pranë AK operatori ekonomik pretendon se vendosja e kriterit të sipërcituar nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike, kufizon konkurrencën e lirë, si dhe bie në kundërshtim me Kodin Rrugor.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik sqaron se: Në nenin 46, pika 1 gërma “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizativc, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”.

Në nenin 26, pika 8, gërrna “e” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

b) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën; [...]”.

Sa më sipër, KSHA gjykon se, kriteret për kualifikim vendosën që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas analizimit të zërave të punimeve që do të kryhen në objektin e prokurimit, gjykon se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e mjeteve Kamioncinë Vetëshkarkues 3 copë me peshë 1,5- 2 ton është një kërkesë e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës dhe në proporcion me të.

Autoriteti kontraktor ka pasur në vëmendje edhe vendodhjen e objektit të prokurimi, e cila është në një qendër të banuar të qytetit të Tiranës, duke limituar kapacitetin mbajtës si më sipër për të mos shkaktuar ndotje akustike, ndotje mjedisi, si dhe respektuar kufizimet e qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë në qytetin e Tiranës.

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se autoriteti kontraktor në mënyrë të arsyeshme e proporcionale ka vendosur kriterin e kapacitetit mbajtës të kamioncinave, në funksion të realizimit me sukses të kontratës, duke patur parasysh se autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme, duke demonstruar kapacitetet teknike për të kryer punët e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, në drejtim të realizimit me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës i cili ka të drejtën të përcaktojë nevojat e tij si dhe të kërkojë nga operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, gjithnjë në përputhje dhe në proporcion me përmasat dhe volumin e kontratës.

Ju bëjmë me dije se kërkesa për disponimin e mjeteve kamioncina me kapacitet mbajtës 1,5-2 ton nuk kufizon pjesëmarrjen e lirë të operatorëve ekonomikë në procedurën objekt ankiminri pasi nga eksperiencat e mëparshme të prokurimeve publike të zhvilluara nga autoriteti kontraktor është konstatuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur mjete me kapacitet mbajtës 1,5- 2 ton.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.4. Në datën 29.07.2020 operatori ekonomik “Leon Konstruktion” sh.p.k, ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime që ka parashtruar tek autoriteti kontraktor.

II.5. Në datën 10.08.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k, se: “Vendosja e këtij kriteri është shumë absurd dhe në kundërshtim me Kodin Rrugor dhe disa nene të ligjit të prokurimit publik.

Neni 1/c e Ligjit Nr. 9643, dt.20.11.2006 (i ndryshuar), kryesisht atë të vet qëllimit që LPP ka: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

Parimet e përzgjedhjes

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Autoriteti kontraktor duhet të bazohet në parashikimet ligjore, kur kërkon kategorizimin e mjeteve sipas ngarkesave të caktuara, pasi duke mos qënë në përputhje me parashikimet ligjore, kryesisht të ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, con në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këto procedura dhe në konkurrencë jo të drejtë.

Pra me fjalë të thjeshta një kamioncinë ka masë maksimale jo më të madhe se 3.5 ton dhe kuptohet shumë thjeshtë që aftësia mbajtëse e tij është më e vogël se kjo masë.

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë arsye ligjore në vendosjen e këtij rregulli si psh: terrene të këqija apo dhe të vështira të cilat nuk lejojnë kamiona mbi këtë peshë pasi vetë autoriteti kërkon kamiona etj.

Gjithashtu e vetmja arsye e vendosjes së këtij kriteri kufizues është uljen e konkurrencës së lirë, mospjesëmarrje të drejtë dhe të lirë të operatorëve ekonomikë.

Nga sa më sipër kërkojmë : Modifikimin e këtij kriteri ku të kërkojen vetëm”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.12 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

“12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera

<i>Autovinc</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompë uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Prerese asfalti</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine per ngjitje tubash PE</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Saldatrice</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 35 copë*
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë*
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë*

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjete, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjete (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaroi se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, UKT sha.

h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.”.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.3. Në nenin 26, pika 8, gërma “c” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën; [...]”.

III.1.4. Lidhur me pretendimin e ankimesit përse i përket vendosjes së kapacitetit mbajtës të 3 (tre) copë kamioncinave të kërkuara sipas përcaktimeve të Nenit 47, pika 2/c, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “c) - kategoria N: mjete me motor të destinuar për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota; - kategoria NI: mjete të destinuar për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;”, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes, si edhe informacionit të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: “Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas analizimit të zërave të punimeve që do të kryhen në objektin e prokurimit, gjykon se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e mjeteve Kamioncinë Vetëshkarkues 3 copë me peshë 1,5- 2 ton është një kërkesë e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës dhe në proporcion me të. Autoriteti kontraktor ka pasur në vëmendje edhe vendodhjen e objektit të prokurimi, e cila është në një qendër të banuar të qytetit të Tiranës, duke limituar kapacitetin mbajtës si më sipër për të mos shkaktuar ndotje akustike, ndotje mjedisi, si dhe respektuar kufizimet e qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë në qytetin e Tiranës.”, duke bashkalidhur dhe Urdhëresën nr.14444, datë 06.10.2015, të kryetarit të Bashkisë Tiranë në të cilin urdhëron: “2. Ndalohet qarkullimi i të gjitha mjeteve të trransportit të mallrave prej orës 07.00 – 09.00, si dhe i mjeteve me ngarkesë të përgjithshme mbi 3.5 t, me kufizim prej orës 09.00 – 20.00, në Unazën e Mesme të qytetit, në brendësi të saj, si dhe në akset kryesore hyrëse në të dukë përfshirë dhe rrugët “Sulejman Delvina”, “Avdyl Frashëri”, “Ismail Qemali”, “Rruga e Elbasanit” dhe Bulevardi Bajram

Curri”. Subjektet tregtare do të kryejnë veprimtarinë e tyre furnizuese nga ora 20:00 – 7:00 dhe për mjetet deri 3.5 t edhe nga 09.00 deri 20.00, sipas sinjalistikës së vendosur.”.

III.1.5. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me shqyrtimin që autoriteti kontraktor i ka bërë pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se argumentet e dhëna nga ana e autoritetit kontraktor nuk qëndrojnë pasi vetë Urdhëresa e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nuk pengon qarkullimin e mjeteve deri në 3.5 ton, por me kushtin që të pajisen me leje të posaçme nga bashkia.

Gjithashtu referuar nenit 47, pika 2/c, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, mjetet e transportit të mallrave të kategorisë N1 përfshijnë mjetet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, pra kategorizimi i bërë nga autoriteti kontraktor me lidhur me kapacitetin mbajtës të kamioncinave në intervalin minimum 1.5 ton dhe maksimumi 3.5 ton nuk është sipas përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura dhe për më tepër që në kthimin e përgjigjes dhënë ankimuesit parashtron se: “*Autoriteti kontraktor ka pasur në vëmendje edhe vendodhjen e objektit të prokurimi, e cila është në një qendër të banuar të qytetit të Tiranës, duke limituar kapacitetin mbajtës si më sipër për të mos shkaktuar ndotje akustike, ndotje mjedisi, si dhe respektuar kufizimet e qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë në qytetin e Tiranës.*”, ndërkohë që nga shqyrtimi i mjeteve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në kriterin e sipërpërmendur është parashikuar që ofertuesit të disponojnë edhe kamiona me kapacitet mbajtës më të madh se 3.5 ton, si dhe me kapacitet mbajtës mbi 12 ton.

Sa më sipër pretendimi e ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Leon Konstruktion*” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-65652-07-15-2020, me objekt: “*Përmirësim furnizimi me ujë në zonën e Kasharit*”, me fond limit 13.830.660 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.08.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “*Leon Konstrusion*” sh.p.k.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 852 Protokoli, Datë 29.07.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri